



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M  
K.P.P. 667/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.10.2019 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

**Objekt:** “Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Inpress” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me nr. REF-21522-05-10-2019, me objekt “Printim Faturash”, me fond limit 3.239.994 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 17.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a.

**Ankimues:** “Inpress” sh.p.k.  
Rruga “Siri Kodra, ish –blloku i magazinave, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër sh.a  
Lagjia “3 Heronjtë”, Rr. “Marin Biçikemi” Shkodër

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publi

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 14.05.2019, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*”, me nr. REF-21522-05-10-2019, me objekt “*Printim Faturash*”, me fond limit 3.239.994 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 17.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a.

II.2. Në datën 17.06.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Referuar materialeve të administruara, parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, si dhe dokumentacionit dorëzuar nga ky i fundit pjesë e ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se autoriteti kontraktor në datë 15.07.2019 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- |                                  |                 |              |
|----------------------------------|-----------------|--------------|
| 1. “Adel Security Print” sh.p.k. | 0.0 lekë,       | skualifikuar |
| 2. “Inpress” sh.p.k.             | 2.429.995 lekë  | kualifikuar  |
| 3. “Inform Albania” sh.p.k.      | 2.694.310 lekë, | kualifikuar  |
| 4. “Tim” sh.p.k.                 | 3.239.994lekë,  | skualifikuar |

II.4. Referuar materialeve të administruara, parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionit dorëzuar nga ky i fundit pjesë e ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe sistemit elektronik të prokurimeve konstatohet se autoriteti kontraktor në datë 30.07.2019 ka kryer rivlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët ka në paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1.	“Adel Security Print” sh.p.k.	0.0 lekë,	skualifikuar
2.	“Inpress” sh.p.k.	2.429.995 lekë	skualifikuar
3.	“Inform Albania” sh.p.k.	2.694.310 lekë,	kualifikuar
4.	“Tim” sh.p.k.	3.239.994lekë,	skualifikuar

II.5. Me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor në datën 30.07.2019, ka njoftuar operatorin ekonomik “Inpress” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me arsyetimin si më poshtë vijon:

*nuk përmbush kriterin e kontratës së ngjashme, pasi shqyrtimit administrativ të ankesës së një operatori ekonomik. Furnizimet e ngjashme të paraqitura nuk mund të konsiderohen të tilla pasi nuk kanë prinitim faturuash në formatin selfmailer për analogji sipas vendimit nr. 272/2017 të komisionit të prokurimit publik.*

II.6. Operatori ekonomik “Inpress” sh.p.k. në datën 02.08.2019 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomikënë procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht operatori ekonomik ankimues në ankesën e tij argumenton si më poshtë vijon: [...]*Te nderuar zoterinj,*

*I. Ne daten 15.05.2019 eshte publikuar nga autoriteti kontraktor Ujesjelles-Kanalizime Shkoder sh.a, ne Sistemin e Prokurimeve Eleknomike ne faqen e internetit te Agjencise se Prokurimit Publik, procedura e prokurimit objekt: "Printim faturash" "Kerkese per Porpozim", me fond limit 3.239.994 (tre mi/ion e dyqind e tridhjete e nente mije e nenteqind e nentedhjete e kater) leke pa TVSH, e cila u zhvillua me date 17.06.2019 (afati perfundimtar per dorezimin e ofertave).*

*Ne daten 15.07.2019 u zhvillua nga Autoriteti Kontraktor Vleresimi i ofertave te tenderit per proceduren e prokurimit te lartpernendur. Ne kete procedure prokurimi paraqiten ofertat ekonomike operatoret ekonornike te poshteshenuar, te cilet autoriteti kontraktor i klasifikoi ne kete menyre:*

1.	“Adel Security Print” sh.p.k.	0.0 lekë,	skualifikuar
2.	“Inpress” sh.p.k.	2.429.995 lekë	kualifikuar
3.	“Info Albania” sh.p.k.	2.694.310 lekë,	kualifikuar
4.	“Tim” sh.p.k.	3.239.994lekë,	skualifikuar

*III. Ne daten 30.07.2019, Autoriteti Kontraktor, Ujesjelles-Kanalizime Shkoder sh.a, ne menyre te cuditshrne, dhe ne kundershtrim me dispozitat ligjore dhe nenligjore te fushes, aktualisht ne fuqi, ne Republiken e Shqiperise, nepermjet faqes zyrtare elektronike te*

APP, ka njoftuar operatorin ekonomik "Inpress" shpk., se oferta e paraqitur prej tij eshte refuzuar per arsyet:

nuk përmbush kriterin e kontratës së ngjashme, pasi shqyrtimit administrativ të ankesës së një operatori ekonomik. Furnizimet e ngjashme të paraqitura nuk mund të konsiderohen të tilla pasi nuk kanë prinitim faturuash në formatin selfmailer për analogji sipas vendimit nr. 272/2017 të komisionit të prokurimit publik.

IV. Gjithashtu, ne daten 30.07.2019, Autoriteti Kontraktor, ka bere edhe rivleresimin e ofertave te paraqitura si rneposhte:

1. "Adel Security Print" sh.p.k.	0.0 lekë,	skualifikuar
2. "Inpress" sh.p.k.	2.429.995 lekë	skualifikuar
3. "Info Albania" sh.p.k.	2.694.310 lekë,	kualifikuar
4. "Tim" sh.p.k.	3.239.994lekë,	skualifikuar

Duke qene se ky vendim i Autoritetit Kontraktor eshte i gabuar, dhe bie ne kundershjim me dispozitat ligjore dhe nenligjore te fushes, ne fuqi, persa i perket aspektit material, ...

... mbeshetur ne nenin 63 pika 1 dhe 2. te ligjit nr 9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik". i ndryshuar. si dhe Vendimit te Keshillit te Ministrave nr.914, date 29.12.2014 "Per rregullat e prokurimit publik". i ndryshuar, ne vijim te procesit te rivleresimit te ofertave per tenderin, dhe brenda afatit 7 ditor nga dita e neserrne e njoftimit nga ana e Autoritetit Kontraktor te ketij vendimi, Ju kerkojme shfuqizimin e ketij vendimi te AK. duke parashtruar kundershjtite tona, si dhe arsyet ligjore ku bazohen keto kundershjtite, si vijon:

Persa i perket vendimit te Autoritetit Kontraktor Ujesjelles-Kanalizime Shkoder sh.a, per skualifikimin e Operatorit Ekonomik "Inpress" shpk., me arsyetimin se: nuk përmbush kriterin e kontratës së ngjashme, pasi shqyrtimit administrativ të ankesës së një operatori ekonomik. Furnizimet e ngjashme të paraqitura nuk mund të konsiderohen të tilla pasi nuk kanë prinitim faturuash në formatin selfmailer për analogji sipas vendimit nr. 272/2017 të Komisionit të Prokurimit Publik", do të donin të parashtronim si më poshtë:

Pasi u konsultuam me Vendimin nr. 272/2017 të Komisionit të Prokurimit Publik, pervec faktit se ne kete vendim nuk gjejme asgje te perbashket ndermjet dy situatave faktike, gjithashtu ne asnje paragraf te ketij vendimi nuk pasqyrohet dhe trajtohet ceshtja e puneve apo kontratave te ngjashme ... Per kete arsye nuk e gjejrne aspak me vend qe AK ne arsyetimin e vendimit te saj, merr per analogji nje vendim te Komisionit te Prokurimit Publik, i cili nuk ka asgje te perbashket me ceshtjen tone konkrete.

Perkundrazi, Komisioni i Prokurimit Publik persa i perket ceshtjes se puneve apo kontratave te ngjashme ka mbajtur nje qendrim konstant, duke parashtruar ne menyre te qarte se:

"... Komisioni i Prokurimit Publik. gijkon se autoriteti kontraktor nuk duhet te vleresoje ne menyre siperfaqesore ngjashmerine midis kontrates objekt prokurimi si edhe kontrates/kontratave te meparshme te dorezuar nga operatoret ekonomike pjesemarres ne nie procedure prokurimi per te provuar eksperiencen e tyre te meparshme por duhet te analizoje elementet konkrete te furnizimeve te krvera me pare referuar kontratave te ngjashme. "...

Ne rmbeshtetje te ketij qendrimi konstant te KPP, rneposhte Ju pasqyrojme gjithashtu vendimin e Komisionit te Prokurimit Publik nr. K.P.P 304/2016, ne te cilen percaktohet shprehimisht: "III. 2.8. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se autoriteti kontraktor ne procesin e shqyrtimit te kontratave te paraqitura per eksperiencia te ngjashme te meparshme duhet te fokusohet jo vetem ne titullin apo objektin e kontrates se ngjashme por duhet te analizoje te gjithe zerat e puneve, mallrave të sherbimeve te kontratave te paraqitura, per te verifikuar dhe konkluduar me pas ne kryerjen ose jo te zerave te tille te ngjashem ne kontratat e realizuara me pare.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor nuk duhet te pretendoie per zera te te njejte sherbimi dhe te kerkoje eksperiencia te njejta, ne kundershtrim me rregullat e prokurimit publik.

III.2.9. Sqarojme se kriteret kualifikuese te percaktuara nga autoriteti kontraktor jane te detyrueshme per t 'u permbushur nga te gjithe ofertuesit ekonomike pjesemarres ne nje procedure prokurimi. Operatoret ekonomike pjesemarres duhet te vertetoine se zoteroine reputacionin, besueshmerine dhe pervojen e duhur, per te zbatuar kontraten objekt prokurimi.

III. 2.10. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbeine autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatoreve ekonomike te cilët nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se gezojne te gjitha kapacitetet ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Ne kete kuptim autoriteti kontraktor nuk duhet te gjykoje ne menyre siperfaqesore e formate por te analizoje ne themel dhe ne menyre te arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit ne funksion te qellimit dhe rrethanave faktike per te cilat vendosen kriteret e percaktuara."

Vendime te tilla te ngjashme te Komisionit te Prokurimit Publik, jane te shumta persa i perket kesaj ceshtje.

Duke u rikthyer ne rastin tone konkret, dote donim te parashtronim se:

a) Punet/furnizimet e ngjashme te paraqitura/depozituara nga operatori ekonomik "Inpress" shpk. per kete procedure tenderuese jane disa here me te medha dhe me te rendesishrne, si nga ana sasiore, ashtu edhe nga ana cilesore dhe profesionale e realizimit te tyre, ne proporcion me cilesine dhe sasine e mallrave objekt prokurimi. Fakt ky qe verteton qartesisht se Operatori Ekonomik "Inpress" shpk. gezon te gjitha kapacitetet ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Thene ndryshe, OE "Inpress" shpk., bazuar ne dokumentacion e paraqitur/depozituar prane AK, verteton qartesisht se zoteron reputacionin, besueshmerine dhe pervojen e duhur, per te zbatuar me sukses kontraten objekt prokurimi.

Gjithashtu, sic citohet edhe ne vendimin e Komisionit te Prokurimit Publik nr. K.P.P 304/2016, autoriteti kontraktor ne procesin e shqyrtimit te kontratave te paraqitura per eksperiencia te ngjashme te meparshme duhet te fokusohet jo vetem ne titullin apo objektin e kontrates se ngjashme por duhet te analizoje te gjithe zerat e puneve, mallrave/ sherbimeve te kontratave te paraqitura, per te verifikuar dhe konkluduar me pas ne kryerjen ose jo te zerave te tille te ngjashem ne kontratat e realizuara me pare.

Eshte e vertete qe objekti/titulli i prokurimit publik ne rastin tone konkret eshte: "Printim Faturash", eshte e vertete gjithashtu qe ne specifikimet teknike te DST percaktohet " ... printim i faturave selfmailer ... ", eshte e vertete gjithashtu se ne punet e ngjashme te paraqitura nga OE "Inpress"

shpk., nuk kane te pasqyruar ne menyre te qarte printimin e faturave, ... .. por nga ana tjeter do te donim te theksonim dhe nenvizonim se:

i)Printimi i faturave objekt prokurimi, eshte nje prej mijerave produkteve/mallrave te ndryshme që realizohen ne nje Shtypshkronje. Bazuar ne kete logjike, nje OE qe operon ne fushen e shtypshkrimeve, do te duhet te kete medoemos pune te ngjashme per secilin prej ketyre rrujera mallrave nese deshiron te marre pjese ne procedura te ndryshme prokuruese.

ii)Legjislacioni shqiptar i fushes se prokurimeve publike ne fuqi, percakton qartesisht terminologjine "pune ose kontrate" te ngjashme. Nese do te merrnim per baze logjiken e KSHA-se, se AK Ujesjelles Kanalizime Shkoder sh.a., atehere legjislacioni shqiptar i fushes se prokurimeve publike do te duhet te percaktonte se punet dhe/ose kontratat e meparshme nuk do te duhet te ishin "te ngjashme", por do te duhet te ishin "te njejtja", ose "identikisht te njejtja" Pasi ne logjiken e AK Ujesjelles Kanalizime Shkoder sh.a., ne rastin konkret "pune ose kontrate" e ngjashme ne rastin konkret do te duhet te konsiderohet realizimi i puneve/furnizimeve te meparshme ne prodhimin e "printimit te faturave self mailer". Thene ndryshe, bazuar ne kete logjike, AK Ujesjelles Kanalizime Shkoder sh.a., nuk po kerkon "pune te ngjashme", por qartesisht po kerkon "pune te njejtja", apo edhe me keq "pune identikisht te njejtja". Kerkese kjo qartesisht ne kundershtrim si me frymen, ashtu edhe me dispozitat e LPP-se.

iii)Gjithashtu, ketu do te donim te theksonim se printimi i faturave selfmailer objekt prokurimi, realizohet nepermjet nje procesi shtypi mjaft te thjeshte, dhe nepermjet vetem 1 (nje) pajisje, e cila i kryen te gjitha proceset e punes nga fillimi dhe deri ne nxjerrjen/realizimin e produktit perfundimtar. Per nje OE (shtypshkronje) si "Inpress" shpk., bazuar ne kapacitetet teknike, burimeve njerezore, dhe pajisjet e teknologjise se fundit qe ka ne dispozicion, realizimi i ketij produkti (printimi i faturave selfmailer) objekt prokurimi, eshte jo vetem lehtesisht i realizueshem, por hyn tek proceset e thjeshta te shtypshkrimeve. Per te gjitha sa u parashtruan mesiper, kerkojme nga AK Ujesjelles Kanalizime Shkoder sh.a., shfuqizimin e vendimit te KSHA-se, kualifikimin e OE "Inpress" shpk., .. .. si dhe shpalljen fitues se procedures se prokurimit publik, objekt i kesaj ankeses, OE "Inpress" shpk.

II.7. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit në datën 08.08.2019, me anë të shkresës nr.1023/2 prot., i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke e refuzuar atë. Konkretisht, autoriteti kontraktor argumenton:

[...]Pershkrimii fakteve te procedures

Nga shqyrtimi i ankeses se paraqitur, dokumentacionit te plote te tenderit ne fjale, si dhe ne te gjithe proceduren e ndjekur per kete tender, UKSH konstatoi:

Me date 13.05.2019 eshte publikuar ne sistemin e app-se procedura e tenderit me objekt Printim faturash" me nr. Ref- 21522-05-10-2019. Me date 17.06.2019 eshte zhvilluar tenderi, ku kane marre pjese keto ofertues:

1. Shoqeria "INPRES" NIPT- L52122014L, vlera 2.429.995 leke
2. Shoqeria "INFORM ALBANIA" NIPT- L11518003F, vlera 2.694.310 leke
3. Shoqeria "TIM" NIPT- K46523066Q, vlera 3.239.994
4. Shoqeria "ADEL SECURITY PRINT" NIPT- KL91605029N, vlera: 0

Me date 15.07.2019 është bërë vlersimi i ofertave, si më poshtë:

1. Shoqëria "INPRES" NIPT- L52122014L, vlera 2.429.995 leke
2. Shoqëria "INFORM ALBANIA" NIPT- L11518003F, vlera 2.694.310 leke

Me datë 30.07.2019 është bërë rivlersimi i ofertave në SPE, pas ankesës së operatorit tjetër të kualifikurës në këtë procedurë, dhe është vendosur:

Skualifikimi i subjektit ofertues INPRESS, si rezultat i rivlersimit të ofertave nga Komisioni i shqyrtimit të ankesave, pasi subjekti juaj nuk plotëson kriterin e furnizimeve të ngjashme të përcaktuara në kriteret e vecanta të kërkesave kualifikimit.

Në kriterin kualifikues 2.3 kapaciteti teknik thuhet:

Furnizime të mëparshme të ngjashme me një vlerë prej 40% të fondit limit të objektit të prokurimit, të realizuar gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit, vertetuar me dokumentacionin vertetues.

-Autoriteti kontraktor (UKSH) si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

-Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga shoqëria INPRESS, rezulton se kjo e fundit ka paraqitur si furnizime të ngjashme fatura tatimore së bashku me listat e mallrave bashkëngjitur që përbehen nga materiale të ndryshme shtypshkrimesh, si psh. Blloqe, librezë, proces-verbale të ndryshme, flete-hyre, flete -dalje, që e përmbushin vlerën 40% të fondit limit të prokurimit, por që asnjë nga zërat e këtyre furnizimeve të ngjashme nuk kanë të bëjnë me 'Printim i fatures dhe zarfim në versionin Seltimailer'.

Në shtojcën nr.10 të DST-ve, thuhet:

<b>Nr</b>	<b>Artikulli</b>	<b>Specifikime teknike</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>
-----------	------------------	----------------------------	---------------	--------------

1	Printimi i faturës dhe zarfim në versionin "Selfmailer"	<p><i>Formati: A4, leter: lazerbond 90gsm. Ngjyra: Logo nga krahu I jashtëm dhe I brendshëm të jenë me ngjyra sipas kodeve të ngjyrave zyrtare të UKSH. Format i vetezarfimit: Afersisht 21cmx10cm. Imazhi i letres së paraprintuar e cila përmban elemente jo variabël nga kopja në kopje, do të jetë e ndryshueshme çdo 3 muaj. Nëse mbas afatit 3-mujor imazhi do të ketë ndryshime, UKSH do të japë kompanisë file-in e ri në format të pershtatshëm për print vektorial) 30 ditë para fillimit të ciklit të prodhimit. Fatura duhet të ketë 2 linja perforimi vertikale aty ku është shenja perkatese (shirit me viza të nderprera). Gjithashtu, në pjesën anësore mbrapa duhet të ketë një numër serial të lotit të fileve, treguesit për zonën dhe numërorin për zonë.</i></p>	cope	341052
---	---	---	------	--------

Nisur nga dokumentacioni i dorëzuar nga ofertuesi "INPRESS", specifikimet teknike të vendosura nga Autoriteti Kontraktor në DST, kjo shoqëri nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në DST dhe as ato të përcaktuara në nenin 28 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014, për arsye se furnizimet e ngjashme që shoqëria juaj ka paraqitur nuk mund të konsiderohen të tilla, pasi asnjë nga to furnizime nuk janë printim faturash e aq më tepër në formën zarfim selmailer. Gjë që nuk garantojnë se operatori juaj ekonomik mund të realizojë me sukses kontratën UKSH.

Si përfundim shoqëria ofertuese "INPRESS" sh.p.k, nuk plotëson kriteret kualifikuese për tu kualifikuar në këtë procedurë prokurimi, pasi sic theksuam më sipër nuk plotëson kriterin e furnizimeve të ngjashme. Në nenin 53 pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 thuhet: Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.

II.7. Në datën 19.08.2019, operatori ekonomik "Inpress" sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

[...][...]Te nderuar zoterinj,

I. Në datën 15.05.2019 është publikuar nga autoriteti kontraktor Ujesjelles-Kanalizime Shkoder sh.a, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit objekt: "Printim faturash" "Kërkese për Porpozim", me fond limit 3.239.994



(tre mi/ion e dyqind e tridhjetë e nente mijë e nentëqind e nentëdhjetë e kater) leke pa TVSH, e cila u zhvillua me date 17.06.2019 (afati perfundimtar per dorezimin e ofertave).

Ne daten 15.07.2019 u zhvillua nga Autoriteti Kontraktor Vleresimi i ofertave te tenderit per proceduren e prokurimit te lartpernendur. Ne kete procedure prokurimi paraqiten ofertat ekonomike operatoret ekonomike te poshteshenuar, te cilet autoriteti kontraktor i klasifikoi ne kete menyre:

- |    |                               |                 |              |
|----|-------------------------------|-----------------|--------------|
| 1. | “Adel Security Print” sh.p.k. | 0.0 lekë,       | skualifikuar |
| 2. | “Inpress” sh.p.k.             | 2.429.995 lekë  | kualifikuar  |
| 3. | “Info Albania” sh.p.k.        | 2.694.310 lekë, | kualifikuar  |
| 4. | “Tim” sh.p.k.                 | 3.239.994lekë,  | skualifikuar |

III. Ne daten 30.07.2019, Autoriteti Kontraktor, Ujesjelles-Kanalizime Shkoder sh.a, ne menyre te cuditshrne, dhe ne kundershtrim me dispozitat ligjore dhe nenligjore te fushes, aktualisht ne fuqi, ne Republiken e Shqiperise, nepermjet faqes zyrtare elektronike te APP, ka njoftuar operatorin ekonomik "Inpress" shpk., se oferta e paraqitur prej tij eshte refuzuar per arsytet:

nuk përmbush kriterin e kontratës së ngjashme, pasi shqyrtimit administrativ të ankesës së një operatori ekonomik. Furnizimet e ngjashme të paraqitura nuk mund të konsiderohen të tilla pasi nuk kanë prinitim faturuash në formatin selfmailer për analogji sipas vendimit nr. 272/2017 të komisionit të prokurimit publik.

IV. Gjithashtu, ne daten 30.07.2019, Autoriteti Kontraktor, ka bere edhe rivleresimin e ofertave te paraqitura si rneposhte:

- |    |                               |                 |              |
|----|-------------------------------|-----------------|--------------|
| 1. | “Adel Security Print” sh.p.k. | 0.0 lekë,       | skualifikuar |
| 2. | “Inpress” sh.p.k.             | 2.429.995 lekë  | skualifikuar |
| 3. | “Info Albania” sh.p.k.        | 2.694.310 lekë, | kualifikuar  |
| 4. | “Tim” sh.p.k.                 | 3.239.994lekë,  | skualifikuar |

Ne daten 02.08.2019 Operatori Ekonomik "Inpress" shpk, ka paraqitur ankese prane Autoritetit Kontraktor, me ane te se ciles kerkonte shfuqizimin e vendimit te KSHA-se, te AK, kualifikimin e OE "Inpress" shpk., si dhe shpallien fitues te procedures se prokurimit publik, objekt i kesaj ankese, OE "Inpress" shpk

VI. Ne daten 08.08.2019, me ane te shkreses nr 1023/2 protokolli, Autoriteti Kontraktor, Ujesjelles-Kanalizime Shkoder sh.a, ka shqyrtuar ankesen duke mos e pranuar ate .

...Duke qene se ky vendim i Autoritetit Kontraktor eshte i gabuar, dhe bie ne kundershtrim me dispozitat ligjore dhe nenligjore te fushes, ne fuqi, persa i perket aspektit material, ...

... mbeshtetur ne nenin 63 pika 1 dhe 2, te ligjit nr 9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik". i ndryshuar, si dhe Vendimit te Keshillit te Ministrave nr.914. date 29.12.2014 "Per rregullate prokurimitpublik", i ndryshuar', ne vijim te procesit te rivleresimit te ofertave per tenderin, dhe brenda afatit 10 ditor nga dita e neserme e njoftimit nga ana e Autoritetit Kontraktor te ketij vendimi, Ju kerkojme shfuqizirnin e ketij vendimi te AK. duke parashtruar kundershтите tona, si dhe arsytet ligjore ku bazohen keto kundershiti, si vijon:

Persa i perket vendimit te Autoritetit Kontraktor Ujesjelles-Kanalizime Shkoder sh.a, per skualifikimin e Operatorit Ekonomik "Inpress" shpk., me arsytimin se: nuk përmbush kriterin e kontratës së

ngjashme, pasi shqyrtimit administrativ të ankesës së një operatori ekonomik. Furnizimet e ngjashme të paraqitura nuk mund të konsiderohen të tilla pasi nuk kanë prinitim faturuash në formatin selfmailer për analogji sipas vendimit nr. 272/2017 të Komisionit të Prokurimit Publik”, do të donin të parashtronim si më poshtë:

Pasi u konsultuam me Vendimin nr. 272/2017 të Komisionit të Prokurimit Publik, pervec faktit se ne kete vendim nuk gjejme asgje te perbashket ndermjet dy situatave faktike, gjithashtu ne asnje paragraf te ketij vendimi nuk pasqyrohet dhe trajtohet ceshtja e puneve apo kontratave te ngjashme ... Per kete arsye nuk e gjejme aspak me vend qe AK ne arsyetimin e vendimit te saj, merr per analogji nje vendim te Komisionit te Prokurimit Publik, i cili nuk ka asgje te perbashket me ceshtjen tone konkrete.

Perkundrazi, Komisioni i Prokurimit Publik persa i perket ceshtjes se puneve apo kontratave te ngjashme ka mbajtur nje qendrim konstant, duke parashtruar ne menyre te qarte se:

"... Komisioni i Prokurimit Publik. gjykon se autoriteti kontraktor nuk duhet te vleresojë ne menyre siperfaqesore ngjashmerine midis kontrates objekt prokurimi si edhe kontrates/kontratave te meparshme te dorezuar nga operoret ekonomike pjesemarres ne nie procedure prokurimi per te provuar eksperiencen e tyre te meparshme por duhet te analizoje elementet konkrete te furnizimeve te krvera me pare referuar kontratave te ngjashme. "...

Ne rmbeshtetje te ketij qendrimi konstant te KPP, rneposhte Ju pasqyrojme gjithashtu vendimin e Komisionit te Prokurimit Publik nr. K.P.P 304/2016, ne te cilen percaktohet shprehimisht: "III. 2.8. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se autoriteti kontraktor ne procesin e shqyrtimit te kontratave te paraqitura per eksperiencia te ngjashme te meparshme duhet te fokusohet jo vetem ne titullin apo objektin e kontrates se ngjashme por duhet te analizoje te gjithe zerat e puneve, mallrave të sherbimeve te kontratave te paraqitura, per te verifikuar dhe konkluduar me pas ne kryerjen ose jo te zerave te tille te ngjashem ne kontratat e realizuara me pare.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor nuk duhet te pretendoie per zera te te njejte sherbimi dhe te kerkoje eksperiencia te njejta, ne kundershtrim me rregullat e prokurimit publik.

III.2.9. Sqarohet se kriteret kualifikuese te percaktuara nga autoriteti kontraktor jane te detyrueshme per t 'u permbushur nga te gjithe ofertuesit ekonomike pjesemarres ne nje procedure prokurimi. Operoret ekonomike pjesemarres duhet te vertetoine se zoteroine reputacionin, besueshmerine dhe pervojen e duhur, per te zbatuar kontraten objekt prokurimi.

III. 2.10. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbeine autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operoreve ekonomike te cilët nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se gezojne te gjitha kapacitetet ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Ne kete kuptim autoriteti kontraktor nuk duhet te gjykoje ne menyre siperfaqesore e formate por te analizoje ne themel dhe ne menyre te arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit ne funksion te qellimit dhe rrethanave faktike per te cilat vendosen kriteret e percaktuara."

Vendime te tilla te ngjashme te Komisionit te Prokurimit Publik, jane te shumta persa i perket kesaj ceshtje.

Duke u rikthyer ne rastin tone konkret, dote donim te parashtronim se:

a) Punet/furnizimet e ngjashme te paraqitura/depozituara nga operatori ekonomik "Inpress" shpk. per kete procedure tenderuese jane disa here me te medha dhe me te rendesishrme, si nga ana sasiore, ashtu edhe nga ana cilesore dhe profesionale e realizimit te tyre, ne proporcion me cilesine dhe sasine e mallrave objekt prokurimi. Fakt ky qe verteton qartesisht se Operatori Ekonomik "Inpress" shpk. gezon te gjitha kapacitetet ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Thene ndryshe, OE "Inpress" shpk., bazuar ne dokumentacion e paraqitur/depozituar prane AK, verteton qartesisht se zoteron reputacionin, besueshmerine dhe pervojen e duhur, per te zbatuar me sukses kontraten objekt prokurimi. Gjithashtu, sic citohet edhe ne vendimin e Komisionit te Prokurimit Publik nr. K.P.P 304/2016, autoriteti kontraktor ne procesin e shqyrtimit te kontratave te paraqitura per eksperienca te ngjashme te meparshme duhet te fokusohet jo vetem ne titullin apo objektin e kontrates se ngjashme por duhet te analizoje te gjithe zerat e puneve, mallrave/ sherbimeve te kontratave te paraqitura, per te verifikuar dhe konkluduar me pas ne kryerjen ose jo te zerave te tille te ngjashem ne kontratat e realizuara me pare. Eshte e vertete qe objekti/titulli i prokurimit publik ne rastin tone konkret eshte: "Printim Faturash", eshte e vertete gjithashtu qe ne specifikimet teknike te DST percaktohet "... printim i faturave selfmailer ...", eshte e vertete gjithashtu se ne punet e ngjashme te paraqitura nga OE "Inpress" shpk., nuk kane te pasqyruar ne menyre te qarte printimin e faturave, ... .. por nga ana tjeter do te donim te theksonim dhe nenvizonim se:

i)Printimi i faturave objekt prokurimi, eshte nje prej mijerave produkteve/mallrave te ndryshme qe realizohen ne nje Shtypshkronje. Bazuar ne kete logjike, nje OE qe operon ne fushen e shtypshkrimeve, do te duhet te kete medoemos pune te ngjashme per secilin prej ketyre rnijera mallrave nese deshiron te marre pjese ne procedura te ndryshme prokuruese.

ii)Legjislacioni shqiptar i fushes se prokurimeve publike ne fuqi, percakton qartesisht terminologjine "pune ose kontrate" te ngjashme. Nese do te merrnim per baze logjiken e KSHA-se, se AK UjesjellesKanalizime Shkoder sh.a., atehere legjislacioni shqiptar i fushes se prokurimeve publike do te duhet te percaktonte se punet dhe/ose kontratat e meparshme nuk do te duhet te ishin "te ngjashme", por do te duhet te ishin "te njejtja", ose "identikisht te njejtja" Pasi ne logjiken e AK Ujesjelles Kanalizime Shkoder sh.a., ne rastin konkret "pune ose kontrate" e ngjashme ne rastin konkret do te duhet te konsiderohet realizimi i puneve/furnizimeve te meparshme ne prodhimin e "printimit te faturave self mailer".Thene ndryshe, bazuar ne kete logjike, AK Ujesjelles Kanalizime Shkoder sh.a., nuk po kerkon "pune te ngjashme", por qartesisht po kerkon "pune te njejtja", apo edhe me keq "pune identikisht te njejtja". Kerkese kjo qartesisht ne kundershtim si me frymen, ashtu edhe me dispozitat e LPP-se.

iii)Gjithashtu, ketu do te donim te theksonim se printimi i faturave selfmailer objekt prokurimi, realizohet nepermjet nje procesi shtypi mjaft te thjeshte, dhe nepermjet vetem 1 (nje) pajisje, e cila i kryen te gjitha proceset e punes nga fillimi dhe deri ne nxjerrjen/realizimin e produktit perfundimtar. Per nje OE (shtypshkronje) si "Inpress" shpk., bazuar ne kapacitetet teknike, burimeve njerezore, dhe pajisjet e teknologjise se fundit qe ka ne dispozicion, realizimi i ketij produkti (printimi i faturave selfmailer) objekt prokurimi, eshte jo vetem lehtesisht i realizueshem, por hyn tek proceset e thjeshta te shtypshkrimeve. Per te gjitha sa u parashtruan mesipër, kerkojme nga AK Ujesjelles Kanalizime Shkoder sh.a., shfuqizimin e vendimit te KSHA-se, kualifikimin e OE "Inpress" shpk., .. .. si dhe shpalljen fitues se procedures se prokurimit publik, objekt i kesaj ankese, OE "Inpress" shpk.

II.8. Në datën 28.08.2019, me anë të shkresës nr.1084/1 prot., datë 26.08.2019, është depozituar pranë Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e palës ankimuese mbi skualifikimin e ofertës së tij me argumentin se “*nuk përmbush kriterin e kontratës së ngjashme, pasi shqyrtimit administrativ të ankesës së një operatori ekonomik. Furnizimet e ngjashme të paraqitura nuk mund të konsiderohen të tilla pasi nuk kanë prinitim faturuash në formatin selfmailer për analogji sipas vendimit nr. 272/2017 të komisionit të prokurimit publik.*” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se :

III.1.1. Në Shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, kapaciteti teknik të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është kërkuar:

*Furnizime te meparshme te ngjashme me nje vlere prej 40% te fondit limit te objektit te prokurimit, te realizuar gjate tre viteve te fundit te aktivitetit te operatorit, vertetuar me dokumentacionin vertetues.*

- *Autoriteti kontraktor (UKSH )si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*
- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

Ndërsa në shtojcën 10 “*Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit*” të dokumentave të procedurës objekt ankimi është përshkruar në mënyrë të qartë objekti dhe qëllimi i shërbimit objektit prokurimi si më poshtë:

<i>Nr</i>	<i>Artikulli</i>	<i>Specifikime teknike</i>	<i>Njesia</i>	<i>Sasia</i>
-----------	------------------	----------------------------	---------------	--------------

1	Printimi i faturës dhe zarfim në versionin "Selfmailer"	<p><i>Formati: A4, leter: lazerbond 90gsm.</i></p> <p><i>Ngjyra: Logo nga krahu I jashtëm dhe I brendshëm të jenë me ngjyra sipas kodeve të ngjyrave zyrtare të UKSH.</i></p> <p><i>Formati I vetezarfimit: Afersisht 21cmx10cm. Imazhi i letres së paraprintuar e cila përmban elemente jo variabël nga kopja në kopje, do të jetë e ndryshueshme çdo 3 muaj. Nëse mbas afatit 3-mujor imazhi do të ketë ndryshime, UKSH do të japë kompanisë file-in e ri në format të pershtatshëm për print vektorial) 30 ditë para fillimit të ciklit të prodhimit. Fatura duhet të ketë 2 linja perforimi vertikale aty ku është shenja perkatese (shirit me viza të nderprera). Gjithashtu, në pjesën anësore mbrapa duhet të ketë një numër serial të lotit të fileve, treguesit për zonën dhe numeratorin për zonë.</i></p>	cope	341052
---	---	--	------	--------

III.1.2. Neni 28 pika 1 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht: *Natyrë e shërbimeve duhet të shprehet qartë në termat e referencës, ku përfshihen objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.*

Ndërsa pika 3 e nenit më sipër parashikon shprehimisht: *“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit”.*

Në vijim në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*

III.1.3. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.*

III.1.4. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, ( S.P.E.) Komisioni konstatoi se në funksion të plotësisimit të kriterit të mësipërm operatori ekonomik ankimues “Inpress” sh.p.k. ka dorëzuar:

1. Fatura Tatimore të Shitjes nr. 13 datë 19.11.2018 në vlerën 11.323.900 lekë pa tvsh, Përshkrimi i mallit ose shërbimit: (Shtypshkrime, blloqe, librezat, libra dhe procesverbale)
2. Fatura Tatimore të Shitjes nr. 12 datë 02.10.2018 në vlerën 14748510 lekë pa tvsh, Përshkrimi i mallit ose shërbimit: (blloqe, librezat, libra dhe procesverbale )

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit dhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

III.1.6. Referuar në mënyrë specifike objektit të prokurimit, kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor si dhe specifikimeve teknike, Komisioni gjykon se ato në tërësinë e tyre shprehin qartë kërkesën e autoritetit kontraktor për natyrën e shërbimit objekt prokurimi, i cili në rastin konkret nuk ka të bëjë thjesht me një proces të printimit dhe zarfimit të faturave, por me një proces i cili është përcaktuar të kryhet sipas një metode të caktuar, i ashtuquajtur versioni Self-mailer. Në analizë të të gjithë dokumentacionit të paraqitur në përmbushje të kriterit për kontrata të ngjashme, Komisioni gjykon se faturat e paraqitura nuk mund të konsiderohen shërbime të ngjashme pasi nuk përmbajnë karakteristikën dhe specifikën e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për mënyrën e realizimit të këtij shërbimi (në versionin Selmailer), si edhe nuk rezulton të jenë kryer eksperiencat të mëparshme të ngjashme me këtë specifikë prokurimi, qoftë edhe në një vlerë minimale për të vërtetuar se ky operator ekonomik është i aftë dhe ka kapacitetet e duhura për të kryer shërbimin/furnizimin e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Këto fatura dëshmojnë vetëm për eksperiencën e operatorit ekonomik ankimues për realizimin e prodhimit të blloqeve, librezave, procesverbaleve të ndryshme etj, por jo në modelin specifik të kërkuar dhe përcaktuar qartë si në objektin e prokurimit ashtu edhe në shtojcën e specifikimeve teknike. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Në rastin konkret operatori ekonomik ankimues me

dokumentacionin e paraqitur nuk ka mundur të përmbushë kërkesën e autoritetit kontraktor për kontrata të ngjashme me objektin printim faturash të cilat kanë një specifikë tjetër nga shtypshkrimet e zakonshme sipas dokumentave të tenderit të publikuara nga autoriteti kontraktor.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Inpress” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me nr. REF-21522-05-10-2019, me objekt “Printim Faturash”, me fond limit 3.239.994 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 17.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a.
2. Autoriteti Kontraktor, lejohet të vazhdojë, me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1416 Protokolli;**

**Datë 19.08.2019**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

<b>Nënkryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Enkeleda Bega</b>	<b>Vilma Zhupaj</b>	<b>Lindita Skeja</b>	<b>Merita Zeqaj</b>

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**